

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës  
Kuvendi i Komunës së Junikut  
Numër: 002/12  
Datë: 20.05.2026

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

**FTESË**

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut  
**Nga:** Leonard Llojuni – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut  
**Lënda:** Mbledhja e postë - (2026) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut  
**Vendi:** Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut  
**Data:** 29.05.2026, ora 10<sup>00</sup>.



**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit,
2. Informatë mbi zhvillimin e turizmit në Komunën e Junikut,
3. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2026/28,
4. Njoftim mbi raportin e performancës për vitin 2024,
5. Raporti i planit të integritetit,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për plotësim-ndryshimin e “Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencionëve”,
7. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Shqipdona Shehu</b>
<b>CC</b>	<b>Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut</b>
<b>TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:</b>	<b>Raporti i punës për tremujorin e parë 2026</b>

I nderuar,

Më poshtë gjeni Raportin e punës për periudhën janar-mars 2026, për sektorin e Turizmit .

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, sektori i turizmit në Komunën e Junikut ka vazhduar me aktivitete të ndryshme të fokusuar në zhvillimin dhe promovimin e turizmit malor dhe kulturor, si dhe në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve turistike. Aktivitetet kanë qenë të orientuara drejt rritjes së promovimit të destinacioneve turistike, forcimit të bashkëpunimit me akterë lokalë dhe rajonalë, si dhe avancimit të proceseve të digjitalizimit në sektor. Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve kryesore dhe zhvillimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Gjatë kësaj periudhe është organizuar një event socializimi në bashkëpunim me klubin alpin “Happy Trails Kosovo”, me pjesëmarrje të akterëve të turizmit, alpinizmit, influencerëve dhe fotografëve. Ky aktivitet ka pasur për qëllim promovimin e potencialit turistik të Junikut dhe krijimin e rrjetëzimeve profesionale ndërmjet akterëve relevantë të fushës. Po ashtu ka vazhduar promovimi në rrjete sociale i Qendrës Informuese Turistike.

Janë realizuar vizita në terren me qëllim promovimin e turizmit malor dhe dimëror, si dhe identifikimin e mundësive për zhvillim të mëtejshëm të shtigjeve dhe atraksioneve natyrore në territorin e komunës. Në kuadër të aktiviteteve promovuese, është marrë pjesë edhe në festivalin rajonal dimëror “Manifestimi i Tretë Rajonal Dimëror – Tromeda Trekufiri 2026 – Një ditë, një majë, një skijator – tri shtete”, i cili ka kontribuar në promovimin ndërkufitar të turizmit malor dhe shkëmbimin e përvojave me akterë rajonalë. Gjithashtu janë realizuar takime dhe koordinime të ndryshme me akterë të turizmit lokal dhe partnerë relevantë, me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve dhe zhvillimit të mëtejshëm të sektorit.

Paralelisht me aktivitetet promovuese, janë në zhvillim disa projekte të rëndësishme infrastrukturore dhe digjitale. Realizimi i webfaqes së Qendrës Informuese Turistike është në proces, me synim krijimin e një platforme moderne për informim dhe promovim të ofertës turistike të Junikut. Po ashtu, digjitalizimi i Qendrës Informuese Turistike dhe i shtigjeve turistike është në zhvillim e sipër, me qëllim modernizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e qasjes së vizitorëve në informacion. Ka filluar ndërtimi i Ballkonit Panoramik si një atraksion i ri turistik me rëndësi të veçantë për promovimin e bukurive natyrore të zonës, ndërsa është në zhvillim edhe Shtegu i Gradinës si pjesë e zgjerimit të ofertës së turizmit malor. Gjithashtu është në planifikim vendosja e sinjalistikës turistike në Kanionin e Junikut, me qëllim orientimin më të mirë të vizitorëve dhe përmirësimin e përvojës së tyre gjatë vizitave.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur një sërë takimesh koordinuese me akterë të ndryshëm të turizmit dhe partnerë lokalë, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe avancimit të projekteve në sektor. Gjithashtu janë realizuar takime për koordinimin e fazës përmbyllëse të projektit “Mirdita Junik”, i cili kontribuon në promovimin kulturor dhe turistik të komunës.

Në përgjithësi, sektori i turizmit në Junik gjatë kësaj periudhe ka shënuar progres të qëndrueshëm në aspektin e promovimit, zhvillimit të projekteve dhe rritjes së bashkëpunimit me akterët relevantë. Një ndër sfidat kryesore që ndikon në dinamikën e zhvillimit të sektorit mbetet kufizimi i buxhetit dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare për realizimin më të shpejtë dhe më të gjerë të projekteve dhe aktiviteteve.

**Shqipdona Shehu**

---



## INFORMATË MBI ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË KOMUNËN E JUNIKUT 2025

Të nderuar/a,

Komuna e Junikut, falë pozitës së saj gjeografike, peizazhit të pasur natyror dhe trashëgimisë së pasur kulturore, përfaqëson një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në nivel lokal dhe kombëtar. Duke e konsideruar këtë sektor si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social, gjatë këtij viti janë ndërmarrë hapa konkretë për fuqizimin e ofertës turistike, përmirësimin e infrastrukturës, ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e resurseve dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e aktiviteteve, projekteve dhe planeve të cilat janë realizuar ose janë në proces për vitin 2025-2026 në drejtim të zhvillimit të turizmit në Komunën e Junikut.

---

### 1. Hapja e Qendrës për Informim Turistik dhe funksionalizimin i Stacionit të Kërkim-Shpëtimit

Më 19 mars 2025, është realizuar me sukses hapja zyrtare e Qendrës për Informim Turistik, një objekt me rëndësi të veçantë për orientimin dhe informimin e vizitorëve që frekuentojnë komunën tonë. Qendra ka për qëllim të jetë pika e parë e kontaktit për turistët, duke ofruar informata për atraksionet natyrore, shtigjet malore, kapacitetet e akomodimit, ngjarjet kulturore dhe aktivitetet që ofrohen në Junik.

Në kuadër të kësaj qendre, tashmë operon edhe Stacioni i Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit të Kosovës, një njësi profesionale e cila funksionon me kapacitet të plotë. Kjo rrit në mënyrë të konsiderueshme sigurinë për turistët, veçanërisht për ata që eksplorojnë zonat alpine dhe shtigjet më të largëta.

### Promovimi digjital dhe rrjetet sociale

Qendra për Informim Turistik ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm në fushën e promovimit digjital. Nga marsi deri në dhjetor 2025, faqet e Qendrës në rrjetet sociale kanë arritur **4,590 ndjekës**, miliona shikime dhe qindra mesazhe nga vizitorë të ndryshëm, duke treguar interes dhe interaktivitet të lartë. Për një periudhë kaq të shkurtër, këto rezultate janë mbresëlënëse dhe dëshmojnë potencialin e madh për tërheqjen e turistëve

---



## **2. Master Plani për Bjeshkët e Junikut – Planifikim Strategjik për Zhvillim të Qëndrueshëm**

Me datë 23 maj 2025, Swisscontact dhe Komuna e Junikut kanë organizuar prezantimin zyrtar të Master Planit për Bjeshkët e Junikut. Ky dokument përfaqëson një platformë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor, duke harmonizuar mbrojtjen e natyrës me zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike.

Ngjarja është organizuar në formë konference dhe do ka bashkuar biznese vendore dhe kombëtare, si dhe investitorë ndërkombëtarë të cilët janë ftuar përmes odave të bizneseve si ajo gjermane, japoneze, amerikane e të tjera. Qëllimi është të nxisim partneritete të reja, të promovojmë potencialin e bjeshkëve dhe të tërheqim investime në sektorin e turizmit malor.

---

## **3. Ndërtimi i Urave Ndërkombëtare të Bashkëpunimit – Takim me tour-operatorë evropianë**

Në vazhden e diplomacisë turistike, më 15 maj 2025, Qendra për Informim turistik ka mirëpritur një grup të përzgjedhur tour-operatorësh nga Italia, Franca dhe vende të tjera të Evropës Perëndimore. Takimi ka pasur për qëllim prezantimin e potencialit të komunës në fushën e turizmit të natyrës, aventurës dhe kulturës.

Përmes këtij takimi nuk u synua vetëm promovimi i Junikut si destinacion turistik, por edhe ndërtimi i rrjeteve të bashkëpunimit, duke e integruar komunën në itinerare ndërkombëtare dhe duke e futur në paketat e agjencive evropiane të turizmit.

---

## **4. Festivali “Ditët e Gjeravicës” – Promovimi i Majës më të Lartë të Kosovës**

Me datat 7 dhe 8 qershor 2025, u organizua edicioni i radhës i festivalit të njohur “Ditët e Gjeravicës”, një ngjarje që është shndërruar tashmë në traditë për Komunën e Junikut. Festivali përfshin aktivitete të ndryshme si ecje malore, ngjitje, muzikë live dhe promovim të produkteve tradicionale.

Kjo ngjarje jo vetëm që nxit vizita turistike, por edhe krijon mundësi për pjesëmarrje të bizneseve vendore, të cilat përfitojnë nga rritja e frekuentimit dhe konsumi i produkteve lokale gjatë festivalit.

Ne kete edicion ka pasur nje buje te madhe , po ashtu edhe promovimi i festivalit nga Qendra per Informim Turistik ka sjelle vizitore te ndryshem.



## 5. Projekti “Mirdita – Junik” dhe Festivali “KAH DRITA”

Në muajin korrik 2025, në kuadër të projektit ndërkomunal “Mirdita – Junik”, u organizua festivali “KAH DRITA”, një ngjarje që synon të gërshetojë natyrën me trashëgiminë kulturore. Ky festival ka një platformë për shfaqje artistike, performanca muzikore, tregje artizanale dhe aktivitete në natyrë.

Paralelisht, projekti “Mirdita–Junik” do të sjellë investime kapitale në shtigjet turistike dhe infrastrukturën mbështetëse:

- Shtigjet e Kanionit dhe Gradinës do të rregullohen dhe shenjëzohen sipas standardeve bashkëkohore.
- Përgjatë rrugës Junik – Gropa e Erenikut zona e eko-fshatrave Gjocaj Jasiq do të ndërtohet ballkoni panoramik, e cila do të ofrojë pamje spektakulare dhe do të jetë pikë atraktive për turistët dhe vizitorët.
- Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur edhe trajnime të ndryshme si : kampi i interpretimit për certifikim të guidave interpretuese, kampi i sikijimit dhe trajnimi për zhvillim të biznesit në turizem .
- Janë formuar paketa turistike të përbashkëta ” JOINT PACKAGE” së bashku me Mirditën , paketat përfshijnë hiking , gastronomi dhe trashëgimë kulturore.
- Po ashtu është krijuar TASTE OF JUNIK ose Shija e Junikut, një produkt promovimi me produktet vendore të krijuara dhe të kultivuara nga bizneset e Junikut .

## 6. Digjitalizimi i Qendrës për Informim Turistik – Rritja e Aksesit dhe Informimit

Gjatë këtij viti është planifikuar të realizohet digjitalizimi i plotë i Qendrës për Informim Turistik, një hap i domosdoshëm për modernizimin e shërbimeve dhe lehtësimin e qasjes në informata për turistët.

Platforma digjitale do të ofrojë informacione në kohë reale për atraksionet turistike, kalendarin e ngjarjeve, akomodimet, shtigjet, hartat dhe shërbimet mbështetëse. Në këtë mënyrë, vizitorët do të kenë mundësi të planifikojnë më mirë qëndrimin e tyre në Junik dhe të eksplorojnë më shumë se vetëm destinacionet kryesore. Në vitin 2026 do të jete e gatshme për turistet dhe vizitorët tonë.



## 7. Shtegu “Via Dinarica” – Infrastruktura dhe Festivali Ndërkombëtar

Një ndër projektet më madhore për vitin 2025 është përfundimi i shenjzimit dhe hapjes së shtegut Via Dinarica në pjesën e Junikut, me gjatësi prej rreth 34 kilometra. Ky shteg është pjesë e një rruge ndërkombëtare që përshkon tërë Ballkanin dhe lidhet me rrjetin evropian të turizmit të ecjes.

Përfundimi i punimeve është berë në muajin maj 2025, ndërsa në muajin gusht është mbajtur Festivali “Via Dinarica”, një ngjarje që ka sjellur alpinistë, turistë dhe media nga rajoni dhe më gjerë. Qëllimi i festivalit është të promovojë Junikun si pikë kyçe në këtë rrjet ndërkombëtar, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe promovimin ndërkombëtar të komunës. Në edicionin e parë të këtij festivali Juniku ka marre pjese ne standin e ngritur ne panairin e Via Dinarica, ku Qendra Informuese Turistike ka sjelle informacione per Junikun dhe ka promovuar ate si nje destinacion te shkelqyer. Në ditën e fundit mbyllja e festivalit ka qen ne bjeshken e Junikut , ku eshte mbajtur ekspozita ” Natyre ne Fokus ” me fotografite e bukura te shkrepura pergjate shtegut Via Dinarica .

## 8. Rruga Junik – Gropa e Erenikut

Një ndër investimet më të rëndësishme infrastrukturore që ka përfunduar brenda vitit 2025 është asfaltimi i rrugës Junik – Gropa e Erenikut. Kjo rrugë, e cila lidh zonën urbane me pjesët më të thella të Bjeshkëve të Erenikut, paraqet një korridor strategjik për zhvillimin e turizmit malor në komunën tonë. Përmes kësaj rruge, vizitorët do të kenë qasje të drejtpërdrejtë dhe të sigurt drejt destinacioneve të njohura për natyrën e virgjër, shtigjet alpine dhe atraksionet e larta të Bjeshkëve të Junikut. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore jo vetëm që do të rrisë ndjeshëm numrin e vizitorëve gjatë tërë vitit, por gjithashtu do të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit aktiv, si ecja malore, eksplorimi i natyrës dhe kampingu. Ky investim është hap kyç për integrimin e potencialit turistik të zonave malore në ofertën e përgjithshme të turizmit të komunës dhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal në këto zona.

## 9. Rritja e numrit të vizitorëve në 2025

Në vitin 2025, **numri i vizitorëve në Junik ka qenë rreth 5 herë më i madh se në vitin 2024**, një rritje e jashtëzakonshme që lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e infrastrukturës, veçanërisht me asfaltimin e rrugës **Junik – Gropa e Erenikut**, dhe me hapjen e **Qendrës për Informim Turistik**, e cila ka promovuar Junikun si destinacion atraktiv për vizitorët vendas dhe të huaj.



Kjo tregon se investimet konkrete në infrastrukturë dhe promovim kanë dhënë rezultate të dukshme në tërheqjen e vizitorëve.

---

## 10. Pjesëmarrja në Panaire Ndërkombëtare të Turizmit

Gjatë vitit 2025, Komuna e Junikut ka marrë pjesë aktive në dy panaire të rëndësishme ndërkombëtare të turizmit:

- **Tourism & Travel Show Albania 2025** në Tiranë – ku është prezantuar oferta turistike e komunës me theks në turizmin malor dhe kulturor.
- **ITB Berlin 2025** – panairi më i madh i turizmit në botë, ku Juniku është prezantuar për herë të parë me një platformë profesionale dhe materiale promovuese që kanë tërhequr interesim nga agjenci dhe investitorë ndërkombëtarë.

Kjo pjesëmarrje ka ndihmuar në promovimin e komunës në tregjet ndërkombëtare dhe në krijimin e kontakteve të reja për bashkëpunim dhe zhvillim të mëtejshëm të turizmit.

---

Gjatë vitit 2026, Komuna e Junikut bashkë me Qendren Informuese Turistike do të vazhdojë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, me fokus në projektet dhe masat konkrete për të rritur dukshmërinë, aksesin dhe përvojën e vizitorëve.

### Prioritetet kryesore për vitin 2026:

- Rregullimi , shenjëzimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve turistike, ndërtimi i ballkonit panoramik në zonën e eko-fshatrave Gjocaj–Jasiq, dhe zhvillimi i paketave turistike për hiking, gastronomi dhe trashëgimi kulturore.
- Digjitalizimi i Qendrës Turistike: Krijimi i platformës dhe website-it të Junikut dhe Qendrës për Informim Turistik, me informacion të detajuar për shtigjet, atraksionet, ngjarjet dhe shërbimet turistike.
- Promovimi dhe orientimi: Paisja me materiale promovuese, tabela orientuese dhe promovuese në pika strategjike dhe të frekuentuara nga vizitorët, po ashtu vendosja e QR code ne keto pika , ne menyre qe turistet dhe vizitoret te marrin info gjate gjithë kohes po ashtu edhe Qendra te kete statistika te sakta.



- Për vitin 2026, planifikohet forcim i mëtjshëm i prezencës online ne rrjetet sociale te INFO POINT, përfshirë kampanja promovuese, përmbajtje interaktive dhe aktivitet të vazhdueshëm me ndjekësit, me qëllim që Juniku të bëhet një destinacion njëherësh i famshëm dhe i dashur për vizitorët virtual dhe real.

Këto masa do të përmirësojnë qasjen në informacion, do të rrisin dukshmërinë e Junikut dhe do të ofrojnë një eksperiencë më të plotë dhe të sigurt për turistët dhe vizitorët.

Duke marrë parasysh aktivitetet dhe projektet e lartpërmendura, është e qartë se turizmi në Junik po ecën drejt një drejtimi të qëndrueshëm, të organizuar dhe gjithëpërfshirës. Me hapa konkretë në infrastrukturë, promovim, siguri dhe bashkëpunim ndërkombëtar, Komuna e Junikut po forcon pozicionin e saj si një destinacion turistik i rëndësishëm në hartën e Kosovës dhe më gjerë.

Qendra Informuese Turistike do të vazhdojë të jetë aktive në zbatimin e projekteve dhe planeve strategjike për të maksimizuar përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore që vijnë nga zhvillimi i turizmit.

**Me respekt,**



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2-155/3450
Një. Org.	2
Nr. i taq.	1
Data	19/05/2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Datë/ Datum/ Date:	19.05.2026
Për/ Za/ To:	z. Leonard Llloni – Kryesues i Kuvendit Komunal
Përmes/ Putem/ Via:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut
Nga/ Od/ From:	z. Besart Tofaj - Nënkrjetar i Komunës së Junikut
Tema/ Subjekti/ Subject:	Kërkesë

I nderuar,

Përmes kësaj kërkesë, dëshirojmë të iniciojmë procedurat për plotësim-ndryshimin e “Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve”, të datës 31.10.2018, me nr. prot. 02-180-9082.

Me këtë plotësim-ndryshim të rregullores duam të propozojmë shtimin e neneve të reja dhe plotësimin e disa prej atyre që janë aktualisht, dhe si rezultat do të parashikojnë:


- Ndarjen e subvencioneve për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;
- Ndarjen e subvencioneve për gratë lehona.

Konsiderojmë se këto plotësime do të ndikojnë pozitivisht në mbështetjen sociale dhe mirëqenien e qytetarëve.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



---

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**

---

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE  
KOMUNALE**

**2026- 2028**

JUNIK, 2025

## I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuar në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-it 2026-2028 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2026/01 për Komunat, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2026-2028.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Junikut mbështetët në Deklaratën e prioritetëve të Qeverisë 2026/2028 dhe kornizën Makro fiskale për të njëjtën periudhë, të dhëna nga MFPT përmes qarkores buxhetore 2026/01 .

Korniza afatmesme buxhetore ( KAB ) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Junikut si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2026 – 2028, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
4. Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

## **II. OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE**

Me kornizën afatmesme buxhetore 2026–2028 të Komunës së Junikut synohen të arrihen këto objektiva:

- ❖ Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- ❖ Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- ❖ Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- ❖ Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- ❖ Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- ❖ Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talenteve etj.

## **III. Perspektiva e politikave fiskale**

### **Korniza makroekonomike**

Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas Deklaratës së prioriteteve të Qeverisë 2026-2028 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

### **Parashikimi i të hyrave komunale**

Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra, siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

**Tabela 1. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale**

	Burimet e te hyrave	2025 Buxheti	2026	2027	2028
			Projeksioni		
<b>1</b>	<b>Gjithsej grantet ndërqeveritare</b>	<b>2,135,201</b>	<b>2,343,311</b>	<b>2,276,299</b>	<b>2,388,486</b>
<b>2</b>	<b>Gjithsej te hyrat vetanake te komunës</b>	<b>204,942</b>	<b>195,301</b>	<b>211,654</b>	<b>212,917</b>
2.1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	16,533	13,500	14,693	14,692
2.2	Te hyrat nga urbanizmi	20,000	10,000	11,000	11,000
2.3	Te hyrat nga administrata	8,100	6,300	6,500	6,500
2.4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	15,100	10,500	11,000	11,000
2.5	Te hyrat nga tatimi ne pronë	93,610	102,727	110,175	111,277
2.6	Të hyrat nga tatimi ne tokë	22,849	26,724	32,336	32,498
2.7	Regjistrimi i Automjeteve	9,500	9,500	9,700	9,700
2.8	Te hyrat nga shëndetësia	8,100	6,000	6,100	6,100
2.9	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	5,100	5,000	5,100	5,100
2.10	Të hyrat tjera	6,050	5,050	5,050	5,050
	<b>TOTALI</b>	<b>2,340,143</b>	<b>2,538,612</b>	<b>2,487,953</b>	<b>2,601,403</b>

**Tabela 2. Vlerësimet e hershme të buxhetit 2026**

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Viti buxhetor (2025)					Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2026)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2027)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2028)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	99.6	12.5	0.2	70	0	116.9	12.5	0.2	30		117.4	12.5	0.2	30		117.9	12.5	0.2	30	
K. Komunal	131.0	4.0				152.4	4.0				153.0	4.0				153.7	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadastr	63.4	16.8			150	67.3	30.0			50	67.6	30.0			20	67.9	30.0			60
D. per Administratë të përgjithshme	97.7	38.3	5.9		10	113.7	31.6	5.9			114.2	31.6	5.9			114.7	31.6	5.9		
D. Buxhet dhe Financave	79.0	9.0	0.1			92.7	7.5	0.1			93.1	9.0	0.1			93.5	9.0	0.1		
D. Ekon. Buqesi, pylltari dhe turizem	68.3	9.5	0.4		150	77.2	14.5	0.4		106.5	77.5	14.5	0.4		76	77.8	14.5	0.4		100
D. Sherbimeve Publike	69.9	35.8	16.0		85	81.6	35.8	26.8		25	82.0	35.8	28.1		20	82.3	35.8	29.0		60
D. e Arsimit	43.4	4.8				50.3	4.8				50.5	4.8				50.7	4.8			
D. e Shëndetsise	21.9	3.2				25.1	3.2				25.2	3.7				25.3	3.7			
ZKK	8.0					9.5					9.5					9.6				
<b>TOTALI:</b>	<b>682.3</b>	<b>134.0</b>	<b>22.6</b>	<b>70</b>	<b>395</b>	<b>786.8</b>	<b>143.9</b>	<b>33.3</b>	<b>30</b>	<b>181.5</b>	<b>790.06</b>	<b>146</b>	<b>34.7</b>	<b>30</b>	<b>116</b>	<b>793.38</b>	<b>146</b>	<b>35.6</b>	<b>30</b>	<b>220</b>
Arsimi parashkol	0.0	0.0	0.0	0	0	65.4	10.0				66.7	10.0				66.0	10.0			
Arsimi fillor	389.8	42.2	6.1		10	455.3	37.2	6.5	40	10	457.2	42.2	6.1	40	10	459.1	42.2	6.1	40	10
Arsimi I mesem	150.6	18.5	4.8			164.5	18.5	4.8			165.2	18.5	4.8			165.9	18.5	4.8		
QKMF	301.6	77.7	7.5		10	404.5	101.4	8.4		10	406.2	100.0	8.2		10	407.9	100.0	8.2		10
Mirqenia Sociale	12.5	2.5	2.0			22.2	2.5	2.0			22.3	3.4	2.0			22.4	3.4	2.0		
<b>SUB TOTALI</b>	<b>1536.8</b>	<b>274.9</b>	<b>42.95</b>	<b>70</b>	<b>415</b>	<b>1899</b>	<b>313.5</b>	<b>54.9</b>	<b>70</b>	<b>201.5</b>	<b>1907.7</b>	<b>320</b>	<b>55.8</b>	<b>70</b>	<b>136</b>	<b>1914.7</b>	<b>320</b>	<b>56.7</b>	<b>70</b>	<b>240</b>

**SPECIFIKACION**

<b>BUXHETI KOMUNAL JUNIK</b>	VITI 2025 (000 EURO)	VITI 2026 (000 EURO)	VITI 2027 (000 EURO)	VITI 2028 (000 EURO)
	<b>2,340</b>	<b>2,539</b>	<b>2,489</b>	<b>2,601</b>

#### IV. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2025.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur përafërsisht me një trend të njëjtë për vitin 2026 gjithashtu edhe për dy vitet tjera pasuese me një trend të rritjes për çdo vjet.

Grandet qeveritare kanë rritje për vitin 2026 gjithashtu me një trend të rritjes në vitet pasuese përjashtimisht grantit të përgjithshëm i cili ka një rënie në vitet pasuese për arsye të aplikimit të ndarjes së këtij granti sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MFPT.

#### Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal

Më datën 15.05.2025 kanë arritur limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2026/2028. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Junikut është si vijon:

**Tabela nr. 3 Limitet fillestare sipas qarkores buxhetore 2026/01**

Limiti fillestar	Granti i Arsimit	Granti i Shëndetësisë	Granti i Përgjithshëm	Gjithsej granti Komunal
<b>2026-Kufijtë e financimit</b>	<b>673,383</b>	<b>487,384</b>	<b>1,182,544</b>	<b>2,343,311</b>
2027-Parashikimet	693,585	502,005	1,080,709	2,276,299
2028-Parashikimet	714,392	517,065	1,157,029	2,388,486

**Tabela nr.4. Projektioni i të hyrave Buxhetore nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake 2026/2028 të Komunës së Junikut**

K. K. Junik	Buxheti - 2026	Buxheti – 2027	Buxheti – 2028
Të hyrat nga granti qeveritar	2,343,311	2,276,299	2,388,486
Të hyrat vetanake	195,301	211,654	212,917
<b>TOTALI</b>	<b>2,538,612</b>	<b>2,487,953</b>	<b>2,601,403</b>

Tabela nr. 5. Korniza afatmesme buxhetore 2026/2028 sipas kufijve fillestar

K. K. Junik	Buxheti – 2026	Buxheti - 2027	Buxheti – 2028
Paga dhe mëditje	1,898,712	1,906,703	1,914,723
Mallra dhe shërbime	313,500	320,000	320,000
Shpenzime komunale	54,900	55,750	56,680
Subvencione	70,000	70,000	70,000
Investime kapitale	201,500	135,500	240,000
<b>TOTALI</b>	<b>2,538,612</b>	<b>2,487,953</b>	<b>2,601,403</b>
<b>Burimet e financimit</b>			
Granti i Qeverisë	2,343,311	2,276,299	2,388,486
Të hyrat vetanake	195,301	211,654	212,917
<b>TOTALI</b>	<b>2,538,612</b>	<b>2,487,953</b>	<b>2,601,403</b>

Më datën 21.08.2025 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2026/02 për Komuna në të cilën janë të specifikuar struktura e shpenzimeve sipas Kategorive ekonomike për vitin 2026 dhe parashikimet për 2027-2028. Sipas kësaj Qarkoreje Buxhetore Buxheti total i Komunës së Junikut është i njëjtë krahasuar me qarkoren e parë. Shuma totale 2,538,612.00€ bazuar ne Strukturën e shpenzimeve për Komunën e Junikut sipas Qarkores 2026/02 është:

- Paga dhe mëditje	1,898,712.00
- Mallra dhe Shërbime	313,500.00
- Shpenzime Komunale	54,900.00
- Subvencione dhe transfere	70,000.00
- Shpenzime Kapitale	201,500.00
<b>Totali</b>	<b>2,538,612.00</b>

Tabela nr. 6. Korniza afatmesme buxhetore 2025/2027 sipas Qarkores 2025/02

K. K. Junik	Buxheti – 2026	Buxheti - 2027	Buxheti – 2028
Paga dhe mëditje	1,898,712	1,908,205	1,917,746
Mallra dhe shërbime	313,500	320,000	320,000
Shpenzime komunale	54,900	55,750	56,680
Subvencione	70,000	70,000	70,000
Investime kapitale	201,500	133,998	236,978
<b>TOTALI</b>	<b>2,538,612</b>	<b>2,487,953</b>	<b>2,601,404</b>
<b>Burimet e financimit</b>			
Granti i Qeverisë	2,343,311	2,276,299	2,388,486
Të hyrat vetanake	195,301	211,654	212,917
<b>TOTALI</b>	<b>2,538,612</b>	<b>2,487,953</b>	<b>2,601,403</b>

\* Planifikimi i buxhetit ne kategorinë e pagave nuk është i mjaftueshëm dhe pritet që të ketë minus në këtë kategori pasi që mjetet e ndara në këtë kategori sipas qarkores 2026/02 nuk mjaftojnë për mbulimin e pagave për vitin 2026 për arsye te kalkulimit te pagave jo te mjaftueshme për pozitat e reja dhe pozitat e paplotësuar.

**Në tabelën vijuese pas pranimit të limiteve finale do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit final sipas programeve për vitet 2026/2028**

**Tabela nr. 7. Shpërndarja e shpenzimeve buxhetore për periudhën 2026/2028 pas qarkores së dytë**

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Vlerësimi i hershëm Viti 1 ( 2026 )					Vlerësimi i hershëm Viti 2 ( 2027 )					Vlerësimi i hershëm Viti 3 ( 2028 )				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	116.5	12.5	0.2	30		117.1	12.5	0.2	30		117.6	12.5	0.2	30	
K. Komunal	155.8	4.0				156.6	4.0				157.3	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadaster	67.8	30.0			20	68.1	30.0			13.193	68.4	30.0			
D. per Administratë të përgjithshme	117.4	31.6	5.9			118.0	31.6	5.9			118.5	31.6	5.9		
D. Buxhet dhe Financave	93.3	7.5	0.1			93.7	9.0	0.1			94.2	9.0	0.1		
D. Ekon .Bujqesi .pylltari dhe turizem	71.7	14.5	0.4		141.5	72.1	14.5	0.4		75.805	72.5	14.5	0.4		110.98
D. Sherbimeve Publike	81.7	35.8	26.8		20	82.1	35.8	28.1		20	82.5	35.8	29.0		40
D. e Arsimit	50.4	4.8				50.7	4.8				51.0	4.8			
D. e Shëndetsise	25.1	3.2				25.3	3.7				25.4	3.7			
ZKK	9.6					9.6					9.7				
<b>TOTALI:</b>	<b>789.34</b>	<b>143.9</b>	<b>33.3</b>	<b>30</b>	<b>181.5</b>	<b>793.321</b>	<b>145.9</b>	<b>34.65</b>	<b>30</b>	<b>109</b>	<b>797.15</b>	<b>145.9</b>	<b>35.58</b>	<b>30</b>	<b>150.98</b>
Arsimi parashkol	74.8	10.0				86.8	10.0				87.2	10.0			
Arsimi fillor	434.1	37.2	6.5	40	10	428.1	42.2	6.1	40	10	430.3	42.2	6.1	40	
Arsimi I mesem	170.0	18.5	4.8			167.3	18.5	4.8			168.1	18.5	4.8		56
QKMF	410.2	101.4	8.4		10	412.3	100.0	8.2		15	414.6	100.0	8.2		30
Mirqenia Sociale	20.2	2.5	2.0			20.3	3.4	2.0			20.4	3.4	2.0		
<b>SUB TOTALI</b>	<b>1898.7</b>	<b>313.5</b>	<b>54.9</b>	<b>70</b>	<b>201.5</b>	<b>1908.2</b>	<b>320</b>	<b>55.75</b>	<b>70</b>	<b>134.00</b>	<b>1917.7</b>	<b>320</b>	<b>56.68</b>	<b>70</b>	<b>237</b>
<b>SPECIFIKACION</b>															
<b>BUXHETI KOMUNAL JUNIK</b>	VITI 2026 (000 EURO)					VITI 2027 (000 EURO)					VITI 2028 (000 EURO)				
	<b>2,539</b>					<b>2,488</b>					<b>2,601</b>				

## Strategjia e shpenzimeve sipas Drejtorive/Programeve dhe deklarata e misionit dhe qëllimeve

ZYRA E KRYETARIT

Kryetari: Ruzhdi Shehu

**Deklarata e misionit:** Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij; ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon zëvendësit dhe drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon Buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerri aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.

Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve etj. Gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë etj. Ofron çasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

**Deklarata e qëllimit:** Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e Komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

Kategoritë buxhetore		2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	116,476.97	117,085.97	117,610.97
2	Mallra dhe shërbime	12,500.00	12,500.00	12,500.00
3	Komunalit	150.00	150.00	150.00
5	Subvencione	30,000.00	30,000.00	30,000.00
6	Kapitalet	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>159,126.97</b>	<b>159,735.97</b>	<b>160,260.97</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>10</b>

**Deklarata e misionit:** Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i Komunës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale. Kuvendi i Komunës mund të miratoi aktet dhe të ndërmerr masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejné brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e Komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

**Deklarata e qëllimit:** Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e për kujdesit publik shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale; turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira, çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk është përcaktuar ndonjë autoritet tjetër.

Kategoritë buxhetore		2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	155,795.20	156,582.70	157,317.70
2	Mallra dhe shërbime	4,000.00	4,000.00	4,000.00
3	Komunalit			
5	Subvencione	-		
6	Kapitalet	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>159,795.20</b>	<b>160,582.70</b>	<b>161,317.70</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	15	15	15

**Deklarata e Vizionit:** Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që u përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre.

**Deklarata e Misionit:** Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative – teknike të drejtorisë dhe ato të Shërbimit Civil Komunal që bien në këtë kompetencë. Udhëheqë me librat amë, të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjellë aktvendime për regjistrime të mëvonshme, përmirësime dhe ndryshime të emrit e mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, zyrën e pritjes, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, logjistikës, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit me vendbanimet dhe fshatrat. Gjithashtu kryen edhe punë të tjera që janë kompetencë e drejtorisë e që janë të bazuara në ligje, statut të Komunës, rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat janë në fuqi.

**Deklarata e Qëllimit:** Koordinimi i punës me Drejtoritë Komunale në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Junikut. Pranimi i lëndëve nga palët dhe procedimi i tyre në zyrat e administratës Komunale, dhënia e informatave për palët lidhur me kërkesat dhe ankesat e tyre. Pajisja e palëve me kohë dhe në mënyrë transparente me dokumentacion personal nga librat e amzës. Përgatitja dhe plasimi me kohë në ueb-faqe të informatave për ecuritë, të arriturat dhe punën në Administratën Komunale si dhe shërbime të tjera që janë në kompetencë të drejtorisë në fjalë.

Kategoritë buxhetore		2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	117,407.65	117,985.15	118,510.15
2	Mallra dhe shërbime	31,600.00	31,600.00	31,600.00
3	Komunalit	5,900.00	5,900.00	5,900.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>154,907.65</b>	<b>155,485.15</b>	<b>156,010.15</b>
<b>Numri I te Punësuarve</b>		<b>13</b>	<b>13</b>	<b>13</b>

Të hyrat vetanake		2026	2027	2028
1.	Te hyrat nga Administrata (Gjendja Civile LAL, LAM etj)	6,300	6,500	6,500
2.				
3.				
<b>TOTALI:</b>		<b>6,300</b>	<b>6,500</b>	<b>6,500</b>

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA****Drejtori: Ardita Hoxha**

**Deklarata e Vizionit:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të jetë çdo herë e saktë në planifikime, e besueshme dhe transparente.

**Deklarata e Misionit:** Menaxhon dhe operon me mjetet buxhetore të Komunës, i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidhur me aktualitetet e ndërlidhura me Buxhetin e Komunës. Përgatit raportet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezantimin e Buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin. Gjithashtu, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa hyn edhe Zyra e Tatimit në pronë, e cila ka si mision inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë, që dedikohen për projekte kapitale, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

**Deklarata e Qëllimeve:**

- Planifikimi i saktë dhe efikas i Buxhetit
- Shpenzimi i Buxhetit në mënyrë racionale dhe në përputhje me ligjet në fuqi
- Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake komunale

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	93,260.07	93,732.57	94,205.07
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	7,500.00	9,000.00	9,000.00
<b>3</b>	Komunalit	100.00	100.00	100.00
<b>5</b>	Subvencione			
<b>6</b>	Kapitalet	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>100,860.07</b>	<b>102,832.57</b>	<b>103,305.07</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>9</b>

<b>Të hyrat vetanake</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1.</b>	Te hyrat nga Tatimi ne pronë	102,727	110,175	111,277
<b>2.</b>	Te hyrat nga Tatimi ne tokë	26,724	32,336	32,498
<b>3.</b>	Te hyrat nga regjistrimi i automjeteve	9,500	9,700	9,700
<b>4.</b>	Te hyrat tjera	2,550	2,550	2,550
	<b>TOTALI:</b>	<b>141,501</b>	<b>154,761</b>	<b>156,025</b>

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INSPEKSIONI      Drejtori: Demokrat Ganijaj**

**Deklarata e misionit:** Misioni i përgjithshëm i DSHP-së është realizimi i suksesshëm i Planit për Parandalimin e Emergjencave, reagimin e shpejtë dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, rritjen e performansës në Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, rritjen e performansës në transportit publik të udhëtarëve, ndriçimin elektrik të qytetit si dhe rritjen e performansës në ndërmarrjet publike për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave.

**Deklarata e qëllimit:** Qëllimi i drejtorisë do të jetë ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të qytetit dhe atyre lokale, ndërtimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit, ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimi i parqeve, shesheve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimi i rrjeteve të reja të ndriçimit publik.

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	81,697.73	82,117.73	82,548.23
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	35,800.00	35,800.00	35,800.00
<b>3</b>	Komunalit	26,750.00	28,100.00	29,030.00
<b>5</b>	Subvencione	-	-	-
<b>6</b>	Kapitalet	20,000.00	20,000.00	40,000.00
	<b>TOTALI</b>	<b>164,247.73</b>	<b>166,017.73</b>	<b>187,378.23</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>8</b>

<b>Të hyrat vetanake</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1.</b>	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	5,000	5,100	5,100
<b>2.</b>				
<b>3.</b>				
	<b>TOTALI:</b>	<b>5,000</b>	<b>5,100</b>	<b>5,100</b>

**Deklarata e Vizionit:**

Zhvillimi, promovimi i turizmit dhe monumenteve kulturore do jetë qëllimi kryesor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, duke marrë parasysh resurset natyrore dhe historinë e qytetit.

**Deklarata e Misionit:**

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe bletarisë, me qëllim tërheqjen e investitoreve për të krijuar një mjedis të favorshëm për qytetarët e Komunës së Junikut.

**Deklarata e Qëllimeve:**

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe bletarisë, me qëllim tërheqjen e investitoreve për të krijuar një mjedis të favorshëm për qytetarët e Komunës së Junikut.

Projektet e hartuara do gjejnë zbatim në disa mënyra: Përmes investimeve kapitale (penda dhe kanale të ujitjes), Ofritit të Shërbimeve Këshillimore, (ngritja e kapaciteteve të fermerëve në menaxhimin e fermave dhe aplikimin e teknologjive të avancuara në prodhimtarin bujqësor), mbështetjes për sektorin e blegtorisë, bletarisë, perimekulturës, pemëtarisë, dhe hulumtimi i burimeve financiare (garantëve dhe subvencione) për sektorin e bujqësisë dhe bletarisë, mbështetje për iniciativat e reja të fermerëve në prodhimtarin bujqësor (ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore).

Ruajtja dhe ripyllëzimi i tokave pyjore, duke parandaluar dhe shëruar nga dëmtuesit dhe sëmundjet që i atakojnë.

Bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, bizneset lokale dhe të jashtëm, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale.

Kategoritë buxhetore		2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	71,738.17	72,105.67	72,478.42
2	Mallra dhe shërbime	14,500.00	14,500.00	14,500.00
3	Komunalit	400.00	400.00	400.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	141,500.00	75,805.00	110,978.00
<b>TOTALI</b>		<b>228,138.17</b>	<b>162,810.67</b>	<b>198,356.42</b>
<b>Numri I te Punësuarve</b>		<b>9</b>	<b>9</b>	<b>9</b>

Të hyrat vetanake		2026	2027	2028
1.	Te hyrat nga ushtrimi i veprimtarive te bizneseve	10,500	11,000	11,000
2.	Ndërrimi i destinimit te tokës	2,500	2,500	2,500
3.				
<b>TOTALI:</b>		<b>13,000</b>	<b>13,500</b>	<b>13,500</b>

**Deklarata e Vizionit:** Komunë e planifikuar dhe ndërtuar sipas planeve hapësinore duke ruajtur mjedisin dhe lehtësuar jetën e qytetarëve, me kadastrë të digjitalizuar dhe shërbime në kohë reale.

**Deklarata e Misionit:** Zbatimi me përpikshmëri i planeve hapësinore , mjedisore dhe azhurnimi i kadastrit në vazhdimësi.

**Deklarata e Qëllimeve:** ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve duke respektuar normat teknike të ndërtimit, planifikimit, ato mjedisore dhe kadastrale.

Kategoritë buxhetore		2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	67,813.19	68,128.19	68,448.44
2	Mallra dhe shërbime	30,000.00	30,000.00	30,000.00
3	Komunalit	-	-	-
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	20,000.00	13,193.00	-
	<b>TOTALI</b>	<b>117,813.19</b>	<b>111,321.19</b>	<b>98,448.44</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>6</b>

Të hyrat vetanake		2026	2027	2028
1.	Te hyrat nga Urbanizmi (lejet e ndërtimit)	10,000	11,000	11,000
2.	Te hyrat nga shërbimet kadastrale	13,500	14,693	14,692
3.				
	<b>TOTALI:</b>	<b>23,500</b>	<b>25,693</b>	<b>25,692</b>

**Deklarata e Vizionit:** DAKRS do të jetë gjithmonë korrekte dhe transparente në të gjitha synimet e saj për ngritjen e cilësisë së arsimit në komunën e Junikut.

**Deklarata e Misionit:** DAKRS, udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet arsimore – administrative- teknike të Drejtorisë dhe shkollave dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë dhe aktet nënligjore në fushën e arsimit në nivel komunal.

**Deklarata e Qëllimeve:** DAKRS, Planifikon udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në drejtori, pjesëmarrjen në procesin e zgjedhjes dhe emërimit të personelit dhe drejtorit në shkollë; bën mbledhjen dhe analizën e informatave për të gjitha çështjet e sistemit në komunë; bën sigurimin e hapësirës së nevojshme shkollore për përfshirjen e të gjithë fëmijëve dhe të rriturve në shkollim; aftësimin e personelit të drejtorisë; transparencën dhe depolitizimin e arsimit; planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit për arsimin komunal; komunikimin me prind dhe publikun për çështje që kanë të bëjnë me procesin arsimor në komunë; dhe punë tjera në fushën e arsimit që obligohet nga komuna dhe MASHT-i. Menaxhon, udhëheqë dhe kryen të gjitha punët përkitazi me lëmin e kulturës në Komunë, organizon punën dhe aktivitetet me rininë në të gjitha fushat, organizon jetën sportive dhe siguron kushte për zhvillimin e sportit.

Administrata, Drejtorja e Arsimit

Kategoritë buxhetore		2026	2027	2028
1	Paga dhe mëditje	50,436.24	50,698.74	50,966.49
2	Mallra dhe shërbime	4,800.00	4,800.00	4,800.00
3	Komunalit	-	-	-
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>55,236.24</b>	<b>55,498.74</b>	<b>55,766.49</b>
<b>Numri I te Punësuarve</b>		<b>5</b>	<b>5</b>	<b>5</b>

Arsimi Parashkollor

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	74,810.96	86,806.35	87,194.85
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	10,000.00	10,000.00	10,000.00
<b>3</b>	Komunalit			
<b>5</b>	Subvencione		-	-
<b>6</b>	Kapitalet	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>84,810.96</b>	<b>96,806.35</b>	<b>97,194.85</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>11</b>

Shkolla fillore ‘‘ EDMOND HOXHA’’

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	434,114.09	428,129.09	430,301.76
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	37,200.00	42,200.00	42,200.00
<b>3</b>	Komunalit	6,450.00	6,100.00	6,100.00
<b>5</b>	Subvencione	40,000.00	40,000.00	40,000.00
<b>6</b>	Kapitalet	10,000.00	10,000.00	-
	<b>TOTALI</b>	<b>527,764.09</b>	<b>526,429.09</b>	<b>518,601.76</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>47</b>	<b>47</b>	<b>47</b>

Shkolla e mesme ‘‘ KUVENDI I JUNIKUT’’

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	170,010.32	167,303.33	168,143.33
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	18,500.00	18,500.00	18,500.00
<b>3</b>	Komunalit	4,800.00	4,800.00	4,800.00
<b>5</b>	Subvencione	-	-	-
<b>6</b>	Kapitalet	-	-	56,000.00
	<b>TOTALI</b>	<b>193,310.32</b>	<b>190,603.33</b>	<b>247,443.33</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>18</b>

**Deklarata e Misionit:**

Misioni i DSHMS-së është zhvillimi dhe sigurimi i shërbimeve efektive për plotësimin e nevojave të popullsisë së Komunës. Sigurimi i kornizës menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme në nivelin primar shëndetësor, përmirësimi i vazhdueshëm kualitativ të shërbimeve shëndetësore.

**Deklarata e Qëllimeve:**

Përmirësimi i duhur i shëndetit të qytetarëve, parandalimi i sëmundjeve ngjitëse, imunizimi dhe vaksinimi, ofrimi i shërbimeve sa më cilësore dhe efikase në kujdesin primar shëndetësor.

Administrata, Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	25,141.14	25,267.14	25,395.24
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	3,200.00	3,700.00	3,700.00
<b>3</b>	Komunalit	-	-	-
<b>5</b>	Subvencione	-	-	-
<b>6</b>	Kapitalet	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>28,341.14</b>	<b>28,967.14</b>	<b>29,095.24</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>

QKMF

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	410,246.30	412,346.30	414,551.30
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	101,400.00	100,000.00	100,000.00
<b>3</b>	Komunalit	8,350.00	8,200.00	8,200.00
<b>5</b>	Subvencione	-	-	-
<b>6</b>	Kapitalet	10,000.00	15,000.00	30,000.00
	<b>TOTALI</b>	<b>529,996.30</b>	<b>535,546.30</b>	<b>552,751.30</b>
	<b>Numri I te Punësuarve</b>	<b>42</b>	<b>42</b>	<b>42</b>

<b>Të hyrat vetanake</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1.</b>	Te hyrat nga Shëndetësia	6,000	6,100	6,100
<b>2.</b>				
<b>3.</b>				
	<b>TOTALI:</b>	<b>6,000</b>	<b>6,100</b>	<b>6,100</b>

Shërbimet sociale

<b>Kategoritë buxhetore</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>
<b>1</b>	Paga dhe mëditje	20,194.34	20,299.34	20,405.91
<b>2</b>	Mallra dhe shërbime	2,500.00	3,400.00	3,400.00
<b>3</b>	Komunalit	2,000.00	2,000.00	2,000.00
<b>5</b>	Subvencione	-	-	-
<b>6</b>	Kapitalet	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>24,694.34</b>	<b>25,699.34</b>	<b>25,805.91</b>
